



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2021

VENDIM
Nr. 493, datë 19.10.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

V E N D O S I :

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Sokol Shehu (relator), Besmir Stroka dhe Hasan Selimi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me Kërkesë: {...};Objekti: “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr.14, viti 2021 në ngarkim të pandehurit {...} akuzuar për veprën penale “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit, mbetur në tentativë”; “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, parashikuar nga nenet 79/b e 22, 279/1 të Kodit Penal dhe në rrethana rënduese sipas nenit 50 të Kodit Penal, germa “a”, “c”, “f/I” dhe “i”.

GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Diamela Goxha si dhe gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gerd Hoxha, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: Sokol Bode; Akuza: “Nenet 283/a/1-22, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT DURRËS

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Valbona Vata, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Dhunë në familje”, parashikuar neni 130/a/4 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Vojsava Osmanaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: Për veprën penale të parashikuar neni 324/a/2 i Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT TIRANË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Korçë, Sonjela Voskopi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Tiranë, çështjen penale me të pandehur{...}, etj.; Akuza: “Vrasje me dashje”; “Mbajtje pa leje të armëve luftarake”, etj.

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Sokol Pina, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Kundër: {...}; Objekti: “Ankim kundër vendimit nr.24 prot., datë 05.02.2021 të Prokurorit për mosfillimin e kallëzimit penal nr.45, datë 12.01.2021”

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Miranda Andoni (relatore), Dritan Banushi dhe Irena Brahim, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Objekti: Shfuqizimi i vendimit datë 04.12.2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje “Për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. 1167 viti 2020”, regjistrimin e këtij procedimi penal dhe kthimin e çështjes për hetime të metjeshe pranë kësaj Prokurorie.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR